



Mbrojtje Rajonale e Mjedisit, Veprim dhe Kohezion në Ballkanin Perëndimor (REA)

Konteksti i projektit

Projekti “Mbrojtje Rajonale e Mjedisit, Veprim dhe Kohezion në Ballkanin Perëndimor” (REA) është nismë rajonale, që zbatohet në 6 vende të Ballkanit Perëndimor (Shqipëri ku IKU është dhe Partneri Kombëtar, Mal i Zi, Serbi, Maqedoni, Kosovë dhe Bonja & Hercegovina), me qëllim ndërgjegjësimin e vendimmarrësve dhe grupet e interesit, që çështjet e mjedisit dhe zhvillimit të qëndrueshëm të shihen si prioritetë në axhendën kombëtare.

Qëllimi i Projektit

Qëllimi i projektit REA ka të bëjë me rritjen e numrit të anëtarëve të Kuvendit të motivuar për të përmirësuar ligjet dhe politikat kombëtare për mjedisin, rritjen e nismave të anëtarëve të Kuvendit në fushën e mjedisit etj.

Në kuadër të REA-s mori jetë edhe Lëvizja Bells, e cila u mbështet nga programi rajonal për mjedisin i Ambasadës së Mbretërisë së Hollandës. Misioni i Lëvizjes Bells është të jetë lider i zhvillimit të qëndrueshëm në vendet e Ballkanit Perëndimor. Përmes nismave të ndryshme, veprimit dhe edukimit, anëtarët e Bells-it nxisin qytetarët e Ballkanit Perëndimor të kërkojnë të drejtën e tyre për një mjedis të shëndetshëm dhe standarde më të mira ekonomike dhe sociale. Anëtarët e Lëvizjes Bells, besojnë se



nuk ka limite dhe kufinj administrativë për çështjet e mjedisit, nuk ka ngjyra të partive politike dhe vetëm nëpërmjet dialogut, bashkëpunimit dhe përputhshmërisë së legjislacionit mund të arrihen ndryshime pozitive në këtë fushë.

Rezultatet e REA-s dhe Lëvizjes Bells:

- Rritja e bashkëpunimit ndër-sektoral në vendet e Ballkanit Perëndimor lidhur me çështjet e mjedisit.
- Rritja e bashkëpunimit rajonal dhe shkëmbimi i eksperiencave për politikat dhe nismat që lidhen me mjedisin në rajonin e Ballkanit Perëndimor.
- Rritja e njohurive të aktorëve të interesit dhe qytetarëve të Ballkanit

perëndimor mbi vlerat dhe standardet mjedisore të BE-së.

FAKTET KRYESORE

PARTNERET:

- ✓ Ambasada e Mbretërisë së Hollandës

KOHËZGJATIA:

Shtator 2009 – Dhjetor 2010

PËRFITUESIT:

- ✓ Antarët e Parlamentit

KONTAKT:

Zana Vokopola
Drejtoresh Ekzekutive

Instituti i Kërkimeve Urbane

Rr. Asim Vokshi, Nd.14
Hyrja 11, Ap. 56
Tiranë
Tel: +355 4 2256840
E-mail: uri@uri.org.al
Web: www.uri.org.al

Rreth IKU

Që nga viti 1999 Instituti i Kërkimeve Urbane (IKU) ka dhënë rezultate të mëdha për projektet dhe programet e zhvillimit të realizuara në të gjithë Shqipërinë. Puna jonë ynë kryesore përqendrohet në zhvillimin e komunitetit, forcimin e qeverisjes vendore, mbrojtjen e mjedisit, decentralizimin dhe shërbimet publike. Ne kryejmë studime, llobojmë qeverinë, trajnojmë njësitet e qeverisjes vendore, rrisim aksesin e publikut në informacion, dhe lidhim partnerët në punën për zhvillim.. IKU ka punuar me donatorë si USAID, Bashkëpunimi Zvicëran, Ambasada Holandeze, UNDP, Banka Botërore, BE, SIDA, Shoqëri të Hapur / Fondacioni Soros, etj.